



Agjencia Kombëtare e Rinisë

Termet e Referencës

Këshilltar i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Titulli i Pozitës

Këshilltar i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm

Kohëzgjatja

12 muaj

Vendndodhja

Agjencia Kombëtare e Rinisë, Tiranë

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) është institucion i cili garanton dhe promovon të drejtat e të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimin e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në bazë dhe për zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Veprimtaria e AKR-së shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke organizuar përgjegjësitë funksionale me qëllim sigurimin e kushteve për mbështetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut të strukturuar për të realizuar fuqizimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, krijimin e mekanizmave për nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore e të pavarura, në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve që kanë në fokus rininë shqiptare dhe rëndësinë e kësaj të fundit në shoqëri.

Konteksti

Këshilltari i jashtëm i Drejtorit të Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për trajnimin mediatic, zhvillimin e përmbajtjes dixhitale dhe integrimin teknologjik në gazetari, menaxhimin e startup-eve dhe transformimin dixhital, për ofrimin e ekspertizës profesionale për një zhvillim të qëndrueshëm në fushën e turizmit, turizmit ujqor, të promovimit të produktit të dhe destinacioneve turistike me Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR), në funksion të vizibilitetit të aktiviteteve, projekteve dhe programeve të zbatuara nga AKR. Fokusi kryesor rritur ndërjegjësimin mbi rëndësinë dhe rolin e aktiviteteve turistike që zbatohen nga AKR dhe MTKS. Gjithashtu, Këshilltari do të ketë në fokus rritjen rritjen e transparencës dhe ndërveprimin të institucionit.

Përshkrimi i Punës

- ✓ Njohuri per Programet e Debatit Kombetar si te formati “Karl Popper” ashtu dhe te ai Parlamentar;
- ✓ Drejtimin e inovacionit krijues, nxitjen e marrëdhënieve me bashkëpunëtorët, menaxhimin e ekipeve të ndryshme;
- ✓ Bashkëpunon me ekipet brenda Institucionit për të siguruar një komunikim efektiv të progresit dhe sfidave të projektuara;
- ✓ Do të hartojë së bashku me ekspertët e kontraktuar përmbajtjen për materialet informuese në lidhje me aktivitetet që lidhen drejtëpërdrejt me turzimin dhe programe të ndryshme;

- ✓ Lidershhip dinamik në arritjen e qëllimeve strategjike;
 - ✓ Do të jetë përgjegjës për organizimin e aktiviteteve të promovimit, duke përfshirë përgatitjen dhe publikimin e përditësimeve të mediave sociale mbi aktivitetet, projektet dhe programet si dhe përgatitjen e përmbajtjes për fushatën e informimit publik
-

Kualifikimet dhe Përvoja

- Minimumi 3 vit përvojë pune në fushën e Rinisë.
- Njohuri të thelluara të studimeve ekonomike.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërpersonale.
- Aftësi për të koordinuar dhe menaxhuar disa aktivitete në të njëjtën kohë.
- Njohje e shkëlqyer e gjuhës angleze.

Procesi i Aplikimit

- Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivuese duke detajuar përvojën e tyre relevante deri më datë 15.04.2026 ora 16:00 në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Kriteret e Vlerësimit

- Kriteret për vlerësimin e aplikimeve do të jenë:
 - **Faza 1:** Kualifikimet dhe përvoja të cituara në pikën Kualifikimet dhe Përvoja të këtij dokumenti;
 - **Faza 2:** Performanca në intervistë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. (Aplikantët që kalojnë fazën e parë do lajmërohen zyrtarisht për ditën dhe orën e intervistës)

Afati për Aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen deri më datë datë 15.04.2026 ora 16:00 në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al ose fizikisht pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një punëdhënëse me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë dhënë si një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit bazuar në nevojat në zhvillim të organizatës.
